POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Jemeni sulmon Izraelin me raketë, 16 të plagosur në Tel Aviv!

2 Vendimet/ Qeveria shkarkon Dallëndyshe Bicin nga IKMT 6 muaj pas emërimit, rikthehet Ajet Zyberi! Ish-deputeti Xhindi largohet nga 'Illyrian Guard'

3 VIDEO/ Berisha ul në stol Ramadanin, Lazio fiton 1-2 kundër Leçes

4 Akti Normativ/ Punonjësit me paga të ulta në administratë do marrin shpërblim! Qeveria i jep kredi Albcontrol, shkurton fondet për institucionet

5 Federik Ndoci rrëfen 'anën tjetër' të Parashqevi Simakut: Më përjashtuan nga koncerti, sepse ajo nuk donte të këndonte me mua

Kronikë

Vlorë/ Atentat ndaj kushëririt të Inez Hajrullës, 30 vjeçari rëndë në spital! Plagoset dhe një kalimtar, tregtar fruta perimesh! Autorët djegin makinën në Panaja (VIDEO + EMRAT)

30 vjeçarit Kevin Hajrulla iu bë atentat teksa po parkonte makinën pranë postës së Çoles në lagjen 24 maj' të qytetit të Vlorës. Dyshohet se autorët që kanë qenë tre. Plumbat kapën dhe tregtarin. E gjithë zona ku ndodhi atentati ka kamera sigurie që mendohet se kanë filmuar skenën por dhe lëvizjet e autorëve

- Atentati në Vlorë, 30 plumba drejt makinës së Kevin Hajrullës
- VIDEO/ Qytetarët nxjerrin nga makina Kevin Hajrullën
- Drejtori i Policisë: Hajrulla ndodhej në makinë kur u qëllua (VIDEO)
- Flet një dëshmitar: Sapo dëgjova të shtënat u shtriva barkas
- Autorët djegin makinën, Shikoni pamjet -
- VIDEO/ Pamjet e para pas atentatit në Vlorë

Armand Xhelili
18 Dhjetor, 21:50 | **Përditesimi: 19 Dhjetor, 00:37**

Share

VLORË – Qyteti i Vlorës u trondit mbrëmjen e sotme (18 dhjetor 2024) nga një atentat i mirëorganizuar drejt Kevin Hajrullës, i cili ndodhet gjëndje të rëndë në spitalin e Vlorës. 30 plumba u qëlluan drejt tij, e disa prej tyre kapën dhe një kalimtar i rastit, Armand Spahiu 35 vjeç, i cili rezulton të punojë si tregtar shumice i fruta perimeve.

Ngjarja është shënuar rreth orës 21:30 (18 dhjetor 2024) në lagjen 24 maj' në afërsi të postës së Çoles. Nga të dhënat e para hetimore rezulton se objektiv i atentatit ka qenë kushëriri i Inez Hajrullës, i njohur si i forti i Vlorës dhe që ka arritur ti shpëtojë 3 atentateve ndër vite.

Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se autorët, që dyshohet se kanë qenë 3 kanë pritur që 30 vjeçari Hajrulla, i cili rezulton të parkonte benzin ngjyrë gri për të qëlluar në drejtim të tij me breshëri automatiku nga një makinë tip KIA. Plumbat kanë kapur dhe 35 vjeçarin Spahiu.

LEXO EDHE:
Ekskluzive/ Neandertalët në Vlorë! Si u gjetën materialet e rëndësishme që ndryshojnë historinë për Shqipërinë

> *Mbrëmjen e sotme, rreth orës 21:30, në lagjen "24 Maji", Vlorë, në rrethana ende të paqarta, është plagosur me armë zjarri shtetasi **Kevin Hajrulla**, rreth 30 vjeç, i cili udhëtonte me një automjet tip "Benz". Si pasojë e të shtënave, është plagosur me armë zjarri edhe shtetasi **Armand Spahiu**, 35 vjeç, i cili ndodhej në afërsi në momentin e ngjarjes" informoi policia e Vlorës*

Disa minuta më pas policia njoftoi se makina është gjetur e djegur në fshatin Panaja.

Hajrulla rëndë në spital, tregtari jashte rrezikut

Të dy personat janë transportuar menjëherë në Spitalin Rajonal Vlorë dhe ndodhen nën kujdesin e mjekëve. Drejtori i policisë së Vlorës, Elidon Çela, tha se Kevin Hajrulla ndodhet në gjëndje të rëndë për jetën, ndërsa Spahiu është jashtë rrezikut për jetën. Hajrulla rezulton të ketë marrë disa plumba në trup dhe në bark.

Nuk dihet ende e kaluara e 30 vjeçarit dhe nëse atentati ka lidhje me të fortin e Vlorës.

3 autorë djegin makinën gjenden dhe 2 kallashnikove

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Pas krimit autorët kanë djegur makinën, tip KIA në fshatin Panaja, në autostradën Vlorë-Fier. Më pas autorët që dyshohet se janë 3, njëri shoferi e dy autorët pasi kanë djegur makinën KIA, dyshohet se janë larguar me një automjet tjetër. Policia ka gjetur 2 kallashnikovë dhe 2 krehër në makinën e djegur.

> *Gjatë krehjes së zonës në afërsi të fshatit Panaja, është bërë i mundur lokalizimi i automjetit të dyshuar të përdorur nga autorët, i cili është përfshirë nga flakët. Po punohet për shuarjen e zjarrit' informoi policia në orën 22:30 të mbrëmjes së sotme.*

Nga pamjet e siguruara nga Report Tv dhe Shqiptarja.com në vendngjarje janë gjetur një numër i madh gëzhojash. Edhe makina ka dëmtime të mëdha nga plumbat. Ndërkohë në rrjet qarkullon një video ku kalimtarët nxjerrin të plagosurin nga makina për ta dërguar në spital. E gjithë zona ku ndodhi atentati ka kamera sigurie që mendohet se kanë filmuar skenën por dhe lëvizjet e autorëve. Policia ka ngritur postblloqe ndërsa po ushtrohen kontrolle në fshatin Panaja ku dhe është gjetur makina.

Makina e autorëve e djegur

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 00:08

Atentati në Vlorë, 30 plumba drejt makinës së Kevin Hajrullës

Foto: Makina e Kevin Hajrullës

Policia e Vlorës kanë ngritur pika kontrolli në disa zona të qytetit dhe në hyrje e dalje. Ndërkohë kontrolle janë duke u ushtruar në disa banesa të ndryshme në qytet. Sipas burimeve nga policia në drejtim të automjetit ku ndodhej 30 vjeçari Kevin Hajrulla janë qëlluar me shumë se 30 plumba.

Dyshohet se kanë qenë dy persona që kanë qëlluar në drejtim të 30 vjeçarit.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 23:33

VIDEO/ Atentati në Vlorë, policia lëviz automjetin e djegur të autorëve

Policia ka lëvizur nga vendi ku u dogj, automjetin e autorëve që qëlluan me kallashnikov drejt Kevin Hajrullës, duke e plagosur rëndë atë, si dhe një kalimtar, tregtar fruta-perimesh.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 23:05

Atentati në Vlorë, Kevin Hajrulla u qëllua nga disa plumba në bark, ndodhet në gjendje të rëndë! Flet një dëshmitar: Sapo dëgjova të shtënat u shtriva barkas

Një ngjarje e rëndë tronditi mbrëmjen e së mërkurës qytetin e Vlorës, ku dy persona mbetën të plagosur nga të shtënat. Objektivi i sulmit ishte 30-vjeçari Kevin Hajrullah, ndërsa një tjetër person, që punonte në dyqanin e familjes si shitës fruta-perimesh, u plagos aksidentalisht.

Kevin Hajrulla sipas raportimeve të gazetarit Armand Xhelili ka marrë disa plumba në bark dhe ndodhet në spital në gjendje të rëndë.

Ngjarja ka shkaktuar panik te qytetarët, disa prej të cilëve kanë rrëfyer momentet e frikës. Një dëshmitar ka treguar se sapo dëgjoi të shtënat, u shtri në tokë për të shmangur rrezikun.

Autoritetet janë duke hetuar motivet dhe rrethanat e incidentit, ndërsa të plagosurit janë dërguar në spital për trajtim mjekësor.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 22:59

VIDEO/Pak minuta pas atentatit në Vlorë, momenti kur qytetarët nxjerrin nga makina Kevin Hajrullën

Vlora u trondit nga një atentat me kallashnikov ku objektiv ishte Kevin Hajrulla, kushëriri I Inez Hajrullës. Në pamjet e publikuara online shihen momentet pak pas atentatit ku qytetarët përpiqen ti japin ndihmë 30 vjeçarit duke e nxjerrë nga makina për ta transportuar në spital.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 22:55

Atentati në Vlorë, gjenden dy kallashnikov dhe dy krehër në automjetin e djegur nga autorët

Detaje të reja nga atentati në Vlorë mbrëmjen e sotme ku mbetën të plagosur dy persona.

Siç bën me dije gazetari Armand Xhelili autorët kanë djegur makinën në Vlorë-Fier, ku brenda saj ekspertët kanë gjetur dy kallashnikovë me dy krehër, që besohet se janë përdorur në ngjarje.

Atentati ndodhi në lagjen e Çoles, ku një breshëri automatiku tronditi qytetin bregdetar, njëri prej të plagosurve është Kevin Hajrullah, kushëri i largët me Inez Hajrullën, ndërsa tjetri është një kalimtar i rastit, Armand Spahiu.

Në vendin e ngjarjes u gjetën 18 gëzhoja, ndërsa ra në sy edhe një këpucë.

G.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 22:40

Atentati në Vlorë/ Drejtori i Policisë: Kevin Hajrulla ndodhej në makinë kur u qëllua (VIDEO)

Drejtori i policisë së Vlorës, Elidon Çela në një prononcim për median nga vendi i ngjarjes tha se objektivi, Kevin Hajrulla ka qenë në makinë kur është qëlluar, ndërsa Armand Spahiu 35 vjeç ishte gjendur rastësisht aty.

> *"Sot rreth orës 21:30 ka ndodhur një ngjarje e rëndë kriminale ku në lagjen "24 Maji" persona të paidentifikuar kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit K.H., i cili është dëmtuar dhe është në gjendje të rëndë në spitalin rajonal të Vlorës dhe po merr ndihmën e mjekëve. Si pasojë e rë shtënave është plagosur dhe një shtetas tjetër që ishte në vendngjarje por me dëmtime më të lehta. Nga ana jonë është ngritur grupi hetimor dhe në drejtimin e prokurorisë po kryhen të gjitha veprimet hetimore për ngjarjen."*

> *"Aktualisht forcat e zjarrëfikëses dhe policisë ndodhen në vendngjarje dhe po kryejnë veprimet hetimore dhe në vijim do t'ju njoftojmë edhe për detajet e tjera."*

> *"Nga informacionet e para që kemi marrë është qëlluar brenda makinës."*

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 22:16

VIDEO/ Atentati në Vlorë, autorët djegin makinën, Shikoni pamjet

Dy persona kanë mbetur të plagosur në një atentat me armë zjarri të ndodhur mbrëmjen e sotme në lagjen 24 maj' të qytetit të Vlorës.

Njëri prej të plagosurve është identifikuar si Kevin Hajrulla, ndërsa i plagosuri i dytë është Armand Spahiu 35 vjeç.

Report Tv siguron pamjet e makinës së djegur në autostradën Vlorë – Fier, që dyshohet se është e autorëve të atentatit.

S.G/Shqiptarja.com

Share

K.M/S.G/Shqiptarja.com

TAG: inez hajrulla | atentat | Vlore | Kevin Hajrulla | Armand Spahiu

Komento

Komente

Naj Vlonjat Ketu?: 19/12/2024 05:57

Docja?

Përgjigju

Vlora: 19/12/2024 16:40

Po te ishte docja do ishte te morgu jo te trauma tani…po hajt se avash avash do mesoj te gjuajn drejt dhe keta te tjeret

Hallexhiu: 19/12/2024 07:44

Ah mor ini plera qe Po te vjen ora docja buzderi tirona dursi ini trima dilni nga vrima ka burra vlora ska djem kurvash si ini legeni spiuni cones

qe pyet: 19/12/2024 07:25

kam derguar lalen me mision ne dobraq se mi kishte treguar te gjitha pa iu dridhur syri terri e verri

Emi: 19/12/2024 01:00

E duam shqipnin si gjthe europa ha ha ha ha

Përgjigju

Vova: 19/12/2024 00:30

Gjenden 18 gezhoja e 1 KEPUCE KEPUCA MESAZH PER INEZ HAJRULLEN QE S ECEN DOT

Përgjigju

Vlonjati: 18/12/2024 23:15

Ska te fort ne Vlore dhe Shqiperi. Edhe Tan Hoxha qe i lepinte kembet Celajve ne Elbasan e kuptoj sot, te gjithe kan arme. E gjaku nuk falet

Përgjigju

emigranti: 18/12/2024 22:53

shefat ndryshojne, po krimet vazhdojne. apo jo o krieminister?

Përgjigju

temperamenti: 19/12/2024 06:20

Shefat ndryshojnë ,armët e 97 nuk ndryshojnë o plehrat e Saliut.

e'mi-ngranto: 19/12/2024 01:33

edhe kryeminister te ndryshoj prape krimi do vazhdoj. Per ç'do gje fajin kryeministeri e paska, Madje edhe per parashqevin qe u katandis ashtu. Ku do qe te shkoni mentalitet nuk ndryshoni ju emigrantet

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

21 Dhjetor, 15:03

Si e vlerësoni mbylljen e TikTok në Shqipëri për një vit?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Tentuan vrasin të "fortin" e Vlorës/ SPAK kërkon 11 vite burg për Luzin dhe Koroveshin! 2 vite e 9 muaj për Amarildo Nikollin

Keti Banushi

21 Dhjetor, 14:17

VIDEOLAJM/ Makina shpërthen në flakë në Vlorë, shtëllunga tymi mbulojnë zonën

21 Dhjetor, 10:37

Vlorë/ Atentati ndaj Kevin Hajrullës, po kalonte rastësisht, flet i plagosuri tjetër: U shtriva përtokë, mendova se ishin fishekzjarre

Armand Xhelili

20 Dhjetor, 15:30

Mot me shi, ndalohet lundrimi i peshkarexhave në Vlorë! Vijon normalisht për tragetet

20 Dhjetor, 10:29

Vlora, vendi i parë Neandertalian në Shqipëri! Zbulohen pjesë veglash guri që datojnë mbi 40 mijë vjet më parë

20 Dhjetor, 08:05

Atentati ndaj kushëririt të Inez Hajrullës, i riu rëndë te Trauma! U qëllua me 50 plumba, autorët lëvizën me targa italiane të vjedhura (VIDEO)

19 Dhjetor, 07:50

Kroacia kthen mbrapsht 3 ngarkesa me mandarina, me nivele të larta pesticidesh! Ministria e Bujqësisë: U Nisën nga Berati e Fieri, gjobit grumbulluesin

18 Dhjetor, 21:12

Bashkia e Vlorës zhvendos tregun e gjësë së gjallë, tregtarët bëjnë rezistencë: S'vjen njeri të blejë kaposhë në Nartë se është larg

Armand Xhelili

18 Dhjetor, 17:08

Shpërndanin drogë në Sarandë e Delvinë, "Arrest në burg" për 12 persona

Limos Didani

18 Dhjetor, 17:02

I dënuar me 21 vite burg në Itali për trafik droge, konfiskohen dy resorte në Sarandë të Emiljan Burbës! Vlera rreth 3 mln euro (VENDIMI)

18 Dhjetor, 10:04

Arrestohet hajduti i biçikletave në Vlorë, momenti kur kryen një nga grabitjet

17 Dhjetor, 12:00

Atentat në Moskë, vritet gjenerali Kirillov dhe asistenti i tij! Ishte ngarkuar me ruajtjen e armëve bërthamore! Shpërthimi me 300 gr eksploziv pranë Kremlinit! Kievi pranon autorësinë

17 Dhjetor, 08:31

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje